



Ambasada Britanike  
Tiranë

**MONITORIMI I KONTROLLIT TE GJYQESORIT**

**FUNKSIONIMI I INSPEKTORIATEVE TE KONTROLLIT TË  
GJYQËSORIT NË MINISTRINË E DREJTËSISË DHE KLD-SË**

**NJE ANALIZE KRAHASUESE,  
PERFUNDIME DHE REKOMANDIME**

**TIRANE, 2011**

## I. Përshkrimi ligjor

Inspektimi në gjyqësor rregullohet nga kuadri ligjor i mëposhtëm:

- ✚ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- ✚ Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✚ Ligji Nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i ndryshuar;
- ✚ Ligji nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;
- ✚ Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit të KLD-së, e miratuar me vendimin Nr. 195/2/a, datë 05.07.2006, të KLD-së, e ndryshuar; dhe
- ✚ Rregullorja e “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 5745, datë 13/08/2008, të ndryshuar.

Kushtetuta nuk parashikon shprehimisht rregullat mbi inspektimin e gjyqtarëve apo gjykatave, por nga interpretimi sistematik i saj buron mundësia e zhvillimit të inspektimeve në sistemin gjyqësor. Teksa në të sanksionohet një nga parimet më të rëndësishme të funksionimit të shtetit shqiptar, ai i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, gjithashtu disiplinohet edhe vetorganizimi i sistemit gjyqësor. Këto parashikime japin një bazë të mjaftueshme për inspektimin e gjyqtarëve apo gjykatave.

Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, nuk duhet kuptuar që çdo pushtet është i mbyllur dhe i pakontrolluar nga askush. Respektimi i këtij parimi, sipas qëllimit të kushtetutbërësit, garantohet vetëm nëpërmjet sistemit të kontrollit dhe ekuilibrit. Për këtë qëllim, ky parim mund të kuptohet saktësisht vetëm nëse formulimi kushtetues lexohet në tërësinë e tij, nga ku evidentohet qartë, jo vetëm ndarja e tre pushteteve, por edhe balancimi i tyre. Është e vërtetë që Kushtetuta parashikon se këto pushtete janë të pavarura në realizimin e detyrave të ngarkuara në Kushtetutë dhe ligj, por ato balancojnë njëri-tjetrin nëpërmjet bashkëveprimit ndërmjet tyre për ushtrimin e detyrave, duke respektuar, nxitur, mbështetur dhe kontrolluar njëri-tjetrin. Fjala ‘pavarësi’ është duke u përdorur gjithnjë e më shpesh në kontekstin e profesioneve ligjore, megjithatë, nuk ka vend për krijimin e ishujve të izoluar me pushtete diskrecionale të pakontrolluara. Garancia e vërtetë në këtë drejtim është kontrolli dhe balanca, që presupozon intervarësinë përmes krijimit të një rrjeti të bashkëpunimit reciprok dhe të kontrollit reciprok. Gjithashtu, kontrolli dhe balanca nënkupton që të paktën disa çështje vendimtare duhet të jenë subjekt i mekanizmave të kontrollit ligjor dhe në disa raste edhe të kontrollit politik demokratik. Nga ky interpretim kuptohet se sistemi gjyqësor mund t’i nënshtrohet kontrollit/inspektimit. Nga ana tjetër, në nenin 147 të Kushtetutës, krahas vetorganizimit të sistemit gjyqësor nëpërmjet funksionimit të KLD-së, parashikohet edhe mundësia e shkarkimit të gjyqtarëve apo kompetenca e KLD-së për të vendosur mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve sipas rregullave të përcaktuara me ligj. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve, vlerësimi i akteve dhe sjelljeve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, apo pamjaftueshmëria profesionale mund të rezultojë vetëm pas një procesi kontrolli/inspektimi. Për këtë arsye, ka një konkluzion të parë të padyshimtë, se në mënyrë indirekte Kushtetuta ka njohur inspektimin/kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarit apo gjykatave.

Kjo është arsyeja që kuadri ligjor i miratuar në bazë të Kushtetutës, ndërsa mbështet parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, parashikon kryerjen e inspektimeve të gjyqtarëve dhe gjykatave nga:

(1) Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë; dhe nga

(2) Inspektorati i KLD-së.

Neni 31 i ligjit nr. 9887/2008 parashikon se gjyqtari i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në rastet dhe me garancitë e parashikuara nga ligji. Ndërkohë që neni 34 i tij, i njuh të drejtën Ministrit të Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor të gjyqtarit pranë KLD-së. Nga rregulli i parashikuar në paragrafin 2, të nenit 34, të ligjit nr. 9887/2008 (që lidhet me afatet e konstatimit të shkeljeve) rezulton se Ministri i Drejtësisë përpara fillimit të procedurës disiplinore kryen inspektime, mbi bazën e të cilave konstaton dhe vlerëson nëse jemi përpara rasteve që përbëjnë shkelje të disiplinës në kuptim të ligjit.

Kompetenca për të kryer inspektim i është njohur në mënyrë eksplicite Ministrit të Drejtësisë në Ligjin Nr. 8678/2001, ku parashikohet se Ministria e Drejtësisë kryen inspektime dhe bën procedimin disiplinor të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit sipas ligjit. Në bazë të këtij parashikimi ligjor, kjo kompetencë përfshihet brenda fushës së veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë (DPÇD), sipas Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”. Në nenin 16 të kësaj rregulloreje përcaktohet se DPÇD ka në objekt të punës së saj kontrollin dhe inspektimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit dhe përgatit rekomandimet për Ministrin e Drejtësisë, lidhur me çështje të objektit të inspektimit.

Nga ana tjetër, në nenin 31 të ligjit Nr. 8811/17.05.2001, parashikohet se Ministri i Drejtësisë kryen inspektimin e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit për organizimin dhe punën e shërbimeve gjyqësore, administrimin gjyqësor, si dhe realizon e vendos për procedimin disiplinor të gjyqtarëve të tyre. Ministri i Drejtësisë kryen inspektime sipas programeve të posaçme tematike ose territoriale, të hartuara kryesisht ose në zbatim të detyrave të caktuara nga KLD, në vijim të procesit të verifikimit të ankesave të shtetasve dhe të subjekteve juridike, si dhe sipas të dhënave, për të cilat vihet në dijeni kryesisht ose nëpërmjet Inspektoratit të KLD-së. Inspektimi synon kontrollin dhe verifikimin e çështjeve që nuk janë objekt i rishikimit gjyqësor. Padyshim që inspektimi nuk nënkupton kontrollin mbi zgjidhjen e drejtë apo jo të çështjes gjyqësore konkrete, si dhe mënyrës së vlerësimit të provave, pasi kjo është kompetencë ekskluzive e gjykatave më të larta, të cilave Kushtetuta i njeh të drejtën e rishikimit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulta.

Në përfundim të inspektimit dhe në bazë të rezultateve të tij, Ministri i Drejtësisë propozon procedimin disiplinor të gjyqtarëve para KLD-së dhe depoziton pranë tij dokumentacionin përkatës. Kërkesa për procedim disiplinor, përveç dokumentacionit me të dhënat përkatëse, të cilat provojnë shkeljen e bërë nga gjyqtari, përmban edhe propozimin për llojin e masës disiplinore që gjykohet se duhet të merret ndaj gjyqtarit.

Ministria e Drejtësisë nuk është organi i vetëm që sipas legjislacionit në fuqi ngarkohet me detyrën e inspektimit të gjyqtarëve dhe gjykatave. Në ligjin Nr. 8811/2001, ku përcaktohet organizimi i KLD-së, parashikohet se në përbërje të tij dhe në varësi të drejtpërdrejtë nga ai, funksionon Inspektorati i KLD-së. Sipas nenit 16 të ligjit nr. 8811/2001, Inspektorati verifikon ose i dërgon Ministrit të Drejtësisë për trajtim ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera që i drejtohen KLD-së për veprime të gjyqtarëve, të vlerësuara në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Inspektorati verifikon vetëm ato ankesa të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor ose për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues. Gjithashtu, Inspektorati i KLD-së verifikon ankesat e shtetasve dhe të subjekteve të tjera drejtuar Ministrit të Drejtësisë, të cilat gjykohen prej tij për t'u ndjekur nga Inspektorati i KLD-së. Në rastin kur vërehen shkaqe ligjore për procedimin disiplinor, relacioni shpjegues dhe dokumentacioni përkatës, nëpërmjet Zëvendëskryetarit të KLD-së, i dërgohen menjëherë Ministrit të Drejtësisë për të gjykuar për procedimin

disiplinor. Nga ana tjetër, Inspektorati i KLD-së kryen verifikime për procedimin disiplinor të propozuar nga Ministri i Drejtësisë, në rastet kur çmohet dhe kërkohet nga KLD dhe përgatit raportin përkatës që paraqitet në mbledhjen e Këshillit nga Zëvendëskryetari.

Në zbatim të Ligjit Nr. 8811/2001 është miratuar Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Në këtë rregullore parashikohet se Inspektorati, kryen verifikimin e ankesave të shtetasve dhe subjekteve drejtuar KLD-së, Ministrisë së Drejtësisë, apo ato të publikuara në media, verifikimin në çdo rast të shqetësimeve apo informacioneve të përcjella nga Kryetarët e gjykatave, si dhe kryen verifikimet me kërkesë të KLD-së, lidhur me procedimet disiplinore të propozuara nga Ministri i Drejtësisë dhe përgatit raportin përkatës. Në rregulloren e Inspektoratit parashikohen dy lloje inspektimesh: i gjyqtarit dhe i gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.

Inspektimi i gjyqtarit mund të jetë *tematik* ose *përgjithshëm* dhe bëhet me vendim të KLD-së. Kryeinspektori ngarkon një ose disa inspektorë, të cilët në përfundim përgatisin raportin e inspektimit.

Inspektorati i KLD-së realizon inspektimin e veprimtarisë gjyqësore përmes tre procedurave:

- a) Nëpërmjet verifikimit të ankesave të subjekteve të ndryshme ndaj çështjeve gjyqësore të veçanta të përfunduara ose ende në gjykim apo ankesave lidhur me veprimtarinë jashtëgjyqësore të gjyqtarit;
- b) Nëpërmjet inspektimit tematik ose të përgjithshëm të gjyqtarit – inspektim, i cili urdhërohet me vendim të KLD-së, dhe mund të ketë karakter njohës të efektivitetit të veprimtarisë, ose bëhet për efekt të evidentimit dhe dokumentimit të shkeljeve disiplinore të tij;
- c) Nëpërmjet vlerësimit profesional të gjyqtarëve, i cili bëhet një herë në tre vjet dhe është diskrecion ekskluziv i KLD-së.

Sikundër rezulton nga përshkrimi i kuadrit ligjor në fuqi, gjyqtarët mund të jenë objekt inspektimi nga Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë dhe Inspektorati i KLD-së. Ndërsa inspektimi nga Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë bëhet mbi bazën e një Urdhri të Ministrit të Drejtësisë, inspektimi nga Inspektorati i KLD-së bëhet mbi bazën e një vendimi të Këshillit.

Në të dy rastet e inspektimeve duhet të mbahet në konsideratë Rekomandimi nr. 94(12)/1994 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës “Mbi pavarësinë, efektivitetin dhe rolin e gjyqtarëve”, ku specifikohet se vendimet e një gjyqtari nuk mund të bëhen objekt rishikimi jashtë sistemit të apelit siç parashikon ligji. Kjo do të kërkonte që inspektimi të mos ketë si qëllim vlerësimin ligjor të vendimmarrjes së gjyqtarit, por aspektet e tjera që lidhen me përmbushjen e rregullt të detyrës.

## **II. Situata ligjore dhe faktike e dy inspektorateve, si dhe problemet e funksionimit**

Sipas kuadrit ligjor në fuqi të dy inspektoratet (i Ministrisë së Drejtësisë dhe i KLD-së) kryejnë inspektime të gjyqtarëve dhe gjykatave. Nën një perspektivë pajtuese interpretimi, ekzistenca e dy inspektorateve nuk përbën problem, por përkundrazi mund të vlerësohet si parashikim që ka si qëllim kontrollin sa më efikas të gjyqtarit, në funksion të garantimit të ushtrimit me përgjegjshmëri të detyrës nga ana e tij. Mirëpo, nga formulimi i dispozitave ligjore në fuqi, **evidentohet një ndërthurje e kompetencave të dy inspektorateve dhe mungesë e kufijve të qartë ndarës të tyre, që krijojnë premisë për mbivendosje të inspektimeve apo mos realizimin e inspektimeve.** Konkretisht, neni 16 i ligjit Nr. 8811/2001, nga njëra anë parashikon mundësinë që Inspektorati i KLD-së, ndërsa përballet me një ankesë të qytetarëve ose subjekteve të tjera juridike për një gjyqtar, të zgjedhë nëse do të inspektojë vetë çështjen ose nëse do t'ia referojë atë Ministrisë së Drejtësisë dhe nga ana tjetër, të njëjtën mundësi, ia njeh edhe Ministrisë së Drejtësisë, kur ankesa depozitohet pranë këtij institucioni. Ky parashikim përveçse konfuz për qytetarët, paraqet edhe rrezik për garantimin e një gjyqësori efektiv dhe të përgjegjshëm sepse minon parimin e funksionimit shtetëror sipas roleve dhe përgjegjësi të ndara.

Në ligj mungojnë rregulla apo kritere orientuese që duhet të mbahen në konsideratë nga Inspektorati i KLD-së apo edhe nga Ministri i Drejtësisë, për të përcaktuar se për cilat ankesa inspektimi do të kryhet nga vetë institucioni pranë të cilit është depozituar ankesa dhe në cilat raste, ankesa do t'ia referohet institucionit tjetër. Pasojë eventuale e një kuadri të tillë ligjor, nuk është vetëm mbivendosja e mundshme që rezulton në kryerje inspektimesh të njëkohshme nga të dy inspektoratet, por edhe mundësia e mospërmbushjes së detyrave të përcaktuara me ligj nga inspektoratet. Kështu, pajisja e të dy institucioneve me diskrecionin për të zgjedhur midis trajtimit të një ankesë vetë apo të referimit të saj tek institucioni tjetër dhe mungesa e kritereve dhe rregullave të qarta që të përcaktojnë *ratio*-n e çdonjërit prej zgjedhjeve, mundet të shpjerë në situata të tilla ku për të njëjtin rast (mbi të njëjtën ankesë) të dy institucionet të çmojnë se inspektimi duhet të kryhet nga institucioni tjetër, duke çuar kështu në vonesa dhe zvarritje të adresimit të problematikave të ngritura nga qytetarët apo subjektet të tjera. Një situatë e tillë nuk i përgjigjet përmbajtjes së së Dokumentit “Parimet themelore lidhur me pavarësinë e organeve gjyqësore”, ku sipas parimit nr. 17, çdo akuzë ose ankesë që bëhet ndaj një gjyqtari gjatë ushtrimit të funksioneve të tij gjyqësore e profesionale duhet të shqyrtohet me shpejtësi dhe objektivitet sipas procedurës më të përshtatshme.

Një situatë ligjore me tipare të mungesës së kufijve të qartë ndarës të kompetencave të dy inspektorateve, mund të çojë në një situatë problematike faktike jo vetëm sa i takon ushtrimit të funksioneve ligjore të secilit prej inspektorateve, por edhe e parë edhe nga perspektiva e qytetarit që kërkon të depozitohet ankesën e tij për një gjyqtar.

Një paqartësi e tillë në ndarjen e kompetencave mund të rezultojë çorientuese për qytetarin dhe prodhon konfuzion në lidhje me organin të cilit i duhet t'i drejtohet.

Gjithashtu, ky kuadër ligjor nuk përmban parashikime të qarta që do të ofronin mundësi reale koordinimi midis dy inspektorateve apo procedura për shkëmbimin e informacionit midis tyre. Mungesa e një parashikimi të tillë krijon mundësinë që burimet njerëzore të të dy inspektorateve të përqendrohen në të njëjtën çështje, duke krijuar shpesh edhe mbingarkesë të panevojshme në punë.

Në disa raste të kohëve të fundit është vërejtur një tendencë për realizimin e inspektimeve të përbashkëta të dy inspektorateve. Konkretisht në VKLD nr. 274, datë 16.02.2011, përcaktohet se KLD:

“1. Diskutoi mbi nevojën e realizimit të një inspektimi tematik të përbashkët ndërmjet Inspektoratit të KLD-së dhe Drejtorisë së Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë, në lidhje me gjykimin e çështjeve civile, me objekt ndryshimin e kombësisë në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit dhe në përfundim, vendosi kryerjen e këtij inspektimi. Ky inspektim do të përqendrohet në evidentimin e vendimeve të cënuara nga gjykatat më të larta dhe shkaqet e cënimit të tyre, ndërtimit të rregullt të ndërgjyqësisë në gjykimin e çështjeve me objekt ndryshim kombësie, si dhe në probleme të tjera procedurale, që mund të hasen në zbatimin e dispozitave urdhëruese të ligjit procedural e material, të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore apo parregullsi të tjera në zbatimin e ligjit. Kohëzgjatja e këtij inspektimi do të jetë dy muaj, në përfundim të të cilit, do t'i paraqitet KLD-së raporti përkatës.

12. Diskutoi mbi problematikën e parashtruar nga Ministri i Drejtësisë, me anë të shkresës nr. 1129 Prot., datë 11.02.2011, në lidhje me shkaqet e shuarjes së masave të sigurimit “arrest në burg”, për të pandehurit në çështjen penale për ngjarjen e ndodhur në Gërdec, si dhe u informua nga kryetari i Gjykatës së Tiranës, mbi masat administrative që janë marrë, në funksion të realizimit të këtij procesi, brenda afateve të arsyeshme ligjore. Gjithashtu, diskutoi mbi problematikën e parashtruar nga anëtarë të Këshillit, në lidhje me ecurinë e një sërë procesesh penale në shqyrtim, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në të cilat, të pandehurve u kanë përfunduar afatet e paraburgimit, para se kjo gjykatë të shprehej me një vendim përfundimtar. Në përfundim u vendos realizimi i një inspektimi tematik të përbashkët midis inspektoratit të KLD-së dhe Drejtorisë së Inspektimit pranë Ministrisë së Drejtësisë. Ky inspektim do të fokusohet në aspektin organizativ të proceseve gjyqësore, respektimin e procedurave ligjore, respektimin e afateve procedurale, si dhe vlerësimin e kostove financiare të procesit. Kohëzgjatja e këtij inspektimi do të jetë dy muaj, në përfundim të të cilit, do t'i paraqitet KLD-së raporti përkatës.”.

Edhe pse në thelb, inspektimi i përbashkët tregon një nivel të lartë bashkëpunimi ndërinstytucional, i cili është në çdo rast i mirëpritur dhe shumë i dobishëm, për nga forma sesi ai realizohet paraqet disa problematika të cilat duhet të shmangen.

Së pari, inspektimi i përbashkët i realizuar me vendim të KLD-së nuk gëzon mbështetje ligjore. KLD, si organ kushtetues i pavarur, duhet të marrë vendime që mbështeten në ligj, duke vendosur vetëm brenda sferës së kompetencave të tij. Në këtë mënyrë, KLD nuk mund të vendosë që inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë të

përfshihet në një inspektim tematik të përbashkët me Inspektoratin e KLD-së. Kjo nuk mund të ndodhë edhe në rast se për një vendimmarrje të tillë është shprehur dakord Ministri i Drejtësisë, në cilësinë e anëtarit *ex officio* të KLD-së. Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë nuk varet nga KLD (ku përfshihet edhe Ministri i Drejtësisë, në cilësinë e anëtarit), por varet nga Ministri i Drejtësisë, si pjesë e pushtetit ekzekutiv. Nëse Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë do të varej nga Ministri i Drejtësisë, në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, atëherë nuk do të bëhej më fjalë për kryerjen e inspektimit në bazë të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, sepse edhe ky inspektorat do të ishte në varësi të sistemit gjyqësor (pjesë e të cilit është edhe KLD). Në këtë kuadër, përcaktimi i fokusit dhe afateve të inspektimit që do të kryejë Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, me vendim të KLD-së duket të mos jetë zbatim i parimit kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. KLD dhe Ministri i Drejtësisë, janë dy institucione të pavarura nga njëra-tjetra. Shprehja e vullnetit të Ministrit të Drejtësisë gjatë vendimmarrjes së KLD-së, nuk mjafton për involvimin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë në një inspektim të përbashkët të përcaktuar me vendim të KLD-së. Nëse do të ishte kështu, atëherë nuk do të kishte asnjë arsye, pse Kushtetuta të bënte dallimin e qartë midis anëtarit *ex-officio* të KLD-së dhe funksionit që ky zyrtar realizon jashtë veprimtarisë së KLD-së. Kjo buron drejtpërsëdrejti nga dallimi që Kushtetuta i bën Presidentit të Republikës, në cilësinë e kryetarit dhe anëtarit *ex-officio* të KLD-së, dhe Presidentit të Republikës, si Kryetar i Shtetit, dallim ky që rezulton i qartë nga procedura e emërimit të gjyqtarëve<sup>1</sup>.

Së dyti, Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë duhet të kryejë inspektime vetëm me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, si pjesë e pushtetit ekzekutiv.

Së treti, një inspektim i përbashkët i dy inspektorateve mbi të njëjtën çështje, nënkupton shfrytëzim joracional të burimeve njerëzore.

Të gjitha këto arsye bëjnë të domosdoshme një ndarje të qartë të kompetencave të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Inspektoratit të KLD-së. Qëndrimi i parë zyrtar mbi ndarjen e kompetencave të dy inspektorateve fillimisht është përvijuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e cila, në Vendimin e saj nr. 11, datë 27.05.2004, ka arsyetuar:

“...kjo Gjykatë çmon se për të dy ligjet, si dhe për ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ekziston nevoja për një përmirësim të tyre. Ekzistenca e dy inspektorateve që duket se dublojnë njëri-tjetrin, përkufizimi dhe përcaktimi i qartë i nocioneve inspektim, kontroll, verifikim, evitimi i ndërthurjes së kompetencave midis dy inspektorateve dhe dy institucioneve (Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së) lidhur me administrimin e drejtësisë e të shërbimeve, si dhe të vendosjes së kufijve të qartë mbi kontrollin në gjykatat dhe gjyqtarët, janë disa nga

---

<sup>1</sup> Sipas nenit 136/3 i Kushtetutës, Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë - anëtar i të cilit është edhe Presidenti i Republikës



çështjet që në kuadrin e përgjithshëm të përmirësimit të legjislacionit kanë nevojë për studim dhe rishikim nga organet përkatëse.”

Nga ana tjetër, Opinioni i Komisionit European mbi aplikimin e Shqipërisë për statusin e shtetit kandidat në Bashkimin European evidenton se:

“... Ka mbivendosje dhe mungesë koordinimi midis dy inspektorateve. Edhe Ministria e Drejtësisë edhe KLD kanë kompetenca dhe zbatojnë procedura që nuk përputhen plotësisht me standardet europiane të inspektimit të gjyqtarëve dhe gjykatave. Vlerësimit të gjyqtarëve i mungon transparencja. Iniciativa për procedurë disiplinore është vetëm në duar të Ministrit të Drejtësisë, pa ndonjë kontroll dhe balancim. Për shkak të faktit se mungesa e procedurave disiplinore është një faktor kyç për karrierat gjyqësore, ka një rrezik konkret ndërhyrjeje nga qeveria në këtë fushë. Si rezultat, nuk ka në fuqi një sistem të përgjegjshëm dhe eficient të inspektimit të gjyqësorit dhe të procedimeve disiplinore për gjyqtarët...”.

Siç evidentohet nga citimet e mësipërme, **përcaktimi i qartë i kompetencave, të ndara saktësisht dhe shmangia e premisave të dublimeve**, përbën domosdoshmëri për eficientësinë e sistemit të inspektimeve.

Një problem tjetër i natyrës ligjore lidhet me **mungesën e kuadrit ligjor që normon veprimtarinë e inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë**, dallim ky esencial me inspektoratin e KLD-së. Kompetencat në lidhje me inspektimet i njihen Ministrit të Drejtësisë dhe ai i ushtron këto kompetenca nëpërmjet strukturës së ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë. Por, ndërsa inspektorati i KLD-së gjen rregullim të përshtatshëm në ligjin dhe aktet nënligjore të KLD-së, veprimtaria e inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi për shërbimin civil dhe nga Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Drejtësisë. Rregullimi i ofruar nga këto akte është i një natyre të përgjithshme, që nuk i përgjigjet specifikës së veprimtarisë që kryen inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, si hallka kyçe që ndërlidh pushtetin ekzekutiv me pushtetin gjyqësor. Parashikimi i detyrave dhe mënyrës së ushtrimit të tyre nëpërmjet akteve të brendshme (si për shembull përkrahjet e punës) lehtësisht të ndryshueshme për nga procedura dhe jo publike për nga natyra, nuk japin garancitë e duhura për efektivitetin e ushtrimit të funksioneve, aq më pak në rastin e një funksioni specifik dhe të një rëndësie të posaçme siç është inspektimi i gjyqtarëve dhe gjykatave. Vlen të theksohet se mungesa e rregullave të qarta në lidhje me funksionimin dhe veprimtarinë e inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë mund të krijojë situata që rrezikojnë garancitë e parimeve të pavarësisë së gjyqësorit dhe të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Mungesa e kuadrit ligjor që normon veprimtarinë e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, çënon edhe të drejtat e gjyqtarit që inspektohet, i cili duhet të njohë kuadrin rregullator që lejon inspektimin e tij në mënyrë që nëse vëren shkelje të këtyre rregullave të ketë mundësi objektive për t'u mbrojtur përpara organit procedues sipas standardeve të procesit të rregullt ligjor.

Veç sa më sipër, **kuadri ligjor mbi inspektimet në gjyqësor nuk përcakton elementët e domosdoshëm të një ankese, në aspektin formal dhe përmbajtësor,**

**të cilët do të udhëhiqnin vendimmarrjen e secilit prej inspektorateve në lidhje me kryerjen ose jo të inspektimit.** Ligji përcakton thjesht se vendimmarrja në lidhje me këtë i përket KLD-së. Një mangësi e tillë, përbën premisë për subjektivizëm, arbitraritet edhe trajtime preferenciale të ankesave, të cilat përveçse mund të çënojnë ankuesin, mund të shërbejnë edhe për ta shndërruar inspektimin në formë presioni ndaj veprimtarisë së gjyqtarit dhe gjykatave.

Nga ana tjetër, sa i takon efektivitetin në trajtimin e ankesave dhe transparencës së veprimtarisë së inspektorateve, **evidentohet mungesa e parashikimeve ligjore dhe rregullave të qarta mbi mënyrën e trajtimit të një ankese të depozituar** pranë tyre, mbi veprimet që kryhen për administrimin e ankesës dhe mbi mundësinë që subjekti që ka vënë në lëvizje secilin prej inspektorateve të vihet në dijeni mbi verifikimin ose jo të ankesës së tij si dhe mbi rezultatin e këtij verifikimi.

Por, krahas problemeve të mësipërme që lidhen me ndërthurjen e kompetencave të inspektorateve dhe që janë esencialisht të natyrës ligjore, ekzistojnë edhe probleme të tjera mbi efektivitetin dhe efizienzën e inspektorateve, premisë bazë për suksesin e të cilave janë burimet njerëzore të rekrutuara e konkretisht, **aspektet cilësore (kualifikimet e kërkuara) dhe aspektet sasiore (numri organik) të stafeve respektive.** Në lidhje me këtë aspekt, evidentohet se, ndërsa sa i takon Inspektoratit të KLD-së, ligji ka parashikuar se inspektorët e kësaj strukture zgjidhen nga radhët e gjyqtarëve që përmbushin kushtet për t'u emëruar gjyqtarë në Gjykatat e Apelit dhe në mungesë të tyre, zgjedhja bëhet ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet (neni 14 i ligjit nr. 8811/2001), **kuadri ligjor për Ministrinë e Drejtësisë, nuk ka parashikime të tilla mbi kriteret që duhet të plotësojnë inspektorët e gjyqësorit.** Emërimi i inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë bëhet sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil, me përjashtim të rastit kur mund të aplikohet neni 28 i ligjit nr. 9877/2008<sup>2</sup>.

Situata faktike në lidhje me emërimet në inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë dëshmon për kërkesa të specifikuar në mënyrë të veçantë për shpalljen e çdo pozicioni pune në përputhje me ligjin për statusin e nëpunësit civil, ku si kriter kryesor për t'u përmbushur nga kandidatët konkurues mund të përmenden: a) arsimi i lartë për Drejtësi; b) mbi 3 vjet eksperiencë pune në organet e gjyqësorit ose në fushën e inspektimit të gjyqësorit; c) njohuri të një gjuhe të huaj; ç) përdorim i programeve bazë në kompjuter; si dhe d) aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese<sup>3</sup>.

Në këtë kontekst, jo vetëm kërkesa për 3 vjet përvojë nuk përbën garanci për ushtrimin efektiv të një funksioni të një rëndësie të posaçme si ai i inspektimit të gjyqësorit, por edhe kërkesa që kjo përvojë të jetë në organet e gjyqësorit, pa

---

<sup>2</sup> Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të KLD-së, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë....

<sup>3</sup> Kriteret të konsultuara nga faja zyrtare e Departamentit të Administratës Publike, <http://ëëë.pad.gov.al/dopaëebpage2/vende vakante.aspx>, në Rubrikën "Vende vakante", pozicioni "Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Gjyqësorit, në Ministrinë e Drejtësisë", konsultuar më datë 15.03.2011.

përcaktuar specifikisht nëse pozicioni duhet të ketë qenë ai i gjyqtarit, apo mjafton që të kandidati të ketë 3 vite eksperiencë pune si sekretar gjyqësor apo kancelar, lë për të dëshiruar. Nga paraqitja e këtyre kërkesave për pozicionin e inspektorit në secilin prej inspektorateve, evidentohet një disbalancë e qartë midis kërkesave për t'u përmbushur nga inspektorët e KLD-së dhe ato të Ministrisë së Drejtësisë, ndërkohë që funksionet që kryejnë dy inspektoratet janë të njëjta.

**Një tjetër disbalancë vërehet edhe në një tjetër element që lidhet me statusin e e inspektorëve të dy inspektorateve, që është paga e inspektorit.** Ndoshta prej kësaj disbalance burojnë edhe kriteret minimaliste që duhet të përmbushin kandidatët për inspektorë në Ministrinë e Drejtësisë. Kështu, ndërsa inspektorët e KLD-së trajtohen me pagën e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë, trajtohen me pagën e përgjegjësit të sektorit në administratën publike. Një diferencë e tillë në trajtimin financiar, për funksione pothuajse të njëjta, mbetet e pajustificuar. Kjo situatë krijon premisa për rekrutimin në pozicionin e inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë të personave jo të përshtatshëm, duke vënë në rrezik vetë funksionin e inspektimit.

Sa i takon aspekteve sasiore, stafi i inspektoratit të KLD-së përbëhet nga 12 inspektorë që drejtohen nga Kryeinspektori (gjithsej 13), ndërsa inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë përbëhet nga 6 inspektorë që drejtohen nga Drejtori<sup>4</sup> (gjithsej 7). Aktualisht, në Republikën e Shqipërisë, sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 6265, datë 16.09.2009, ka 377 gjyqtarë. Është e qartë se **numri i inspektorëve të të dy inspektorateve është i pamjaftueshëm i parë në raport me numrin e gjyqtarëve.** Konkretisht, një inspektor i KLD-së duhet të mbulojë afërsisht 30 gjyqtarë, ndërsa një inspektor i Ministrisë së Drejtësisë duhet të mbulojë 55 gjyqtarë.

### **III. Avantazhet dhe disavantazhet e dy Inspektorateve**

Gjykata Kushtetuese<sup>5</sup> ka konkluduar se ekzistenca e dy inspektorateve nuk çënon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, pra, nuk bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, adresimi i problematikave që lidhen me ndërthurjen dhe mbivendosjen e kompetencave të të dy inspektorateve, ndërsa çon paevitueshmërisht në artikullimin e mendimeve mbi mundësinë e atribuimit të kompetencave të veçanta secilit inspektorat, kërkon domosdoshmërisht elaborimin e avantazheve dhe disavantazheve të secilit prej tyre.

#### **(1) Inspektorati i KLD-së**

##### **➤ Avantazhet:**

---

<sup>4</sup> Sipas strukturës së Ministrisë së Drejtësisë të miratuar me Urdhrin nr. 29, datë 05.02.2010 të Kryeministrit.

<sup>5</sup> Vendimi nr. 11, datë 27.05.2004

1. Kryerja e inspektimeve nga një strukturë e një organi të pavarur i përbërë në shumicën e tij nga gjyqtarë, garanton respektimin e parimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe shmangien e influencave të ekzekutivit mbi veprimtarinë e gjyqtarëve;
2. Kërkesat e parashikuara nga ligji për KLD-në për pozicionin e inspektorit në inspektoratin e Këshillit dhe statusi i tyre, përbëjnë garanci për profesionalizëm dhe efikasitet në përmbushjen e detyrave të tyre;
3. Numri më i lartë i inspektorëve të inspektoratit të KLD-së në raport me numrin organik të inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë (përafërsisht 2-fish më i lartë) përbën premisë për ushtrimin efikas të detyrave.

➤ **Disavantazhet:**

1. Kryerja e inspektimeve ekskluzivisht nga inspektorati i KLD-së shmang parimin e balancimit të pushteteve;
2. Kryerja e inspektimeve ekskluzivisht nga inspektorati i KLD-së, organ me përbërje në shumicën e tij nga gjyqtarë, krijon premisa për një pushtet absolut dhe të mbyllur dhe mund të përbëjë shkak për trajtim preferencial të gjyqtarëve që i/mund t'i nënshtrohen inspektimit;
3. Kryerja e inspektimeve ekskluzivisht nga inspektorati i KLD-së, bën që organi që kryen verifikimin dhe del në konkluzionin që mund të ketë shkak për nisjen e procedimit disiplinor, është në të njëjtën kohë edhe organi që merr vendimin për shkeljen disiplinore. Në këtë mënyrë çënohen standardet për një proces të rregullt ligjor sepse dëmtohen garancitë për një vendimmarrje të paanshme ndaj gjyqtarit që procedohet.

**(2) Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë**

➤ **Avantazhet:**

1. Kryerja e inspektimeve nga inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë përbën garanci për respektimin e parimit të kontrollit dhe baraspeshimit të pushteteve, pasi ekzistenca e këtij inspektorati siguron ndërlidhjen midis ekzekutivit dhe gjyqësorit;
2. Kryerja e inspektimeve nga inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë përbën garanci për gjyqtarin që procedohet për një vendimmarrje të paanshme, pasi ka një diferencë të qartë midis organit që kryen verifikimin dhe inicion procedimin disiplinor dhe organit që merr vendimin për shkeljen disiplinore;
3. Kryerja e inspektimeve nga inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, duke mos lënë hapësira për krijimin e një sistemi të mbyllur (inspektimi i sistemit gjyqësor nga vetë sistemi), rrit garancitë e mbrojtjes së interesit publik inherent në vetë qëllimin e inspektimit të gjyqësorit.

➤ **Disavantazhet:**

1. Dhënia e pushtetit mbi inspektimet ekskluzivisht Ministrin të Drejtësisë mund të interpretohet si cënim i parimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe si ndikimi i politikës mbi gjyqësorin;
2. Mungesa e parashikimeve ligjore mbi kriteret që duhet të përmbushin inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë dhe numri më i ulët i inspektorëve pranë kësaj strukture, mund të krijojë probleme në lidhje me eficientësinë dhe efektivitetin në përmbushjen e funksioneve;
3. Mungesa e përcaktimeve të qarta në ligj ose në rregulloren e Ministrisë së Drejtësisë, në lidhje me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarisë së inspektorëve të Ministrisë së Drejtësisë, mund të përbëjë rrezik për tejkalim kompetencash.

#### **IV. Përfundime dhe rekomandime**

Në dritën e sqarimeve të mësipërme, **në aspektin ligjor dhe në funksion të përmirësimit të kuadrit ligjor ekzistues, lind nevoja e përcaktimit në mënyrë të qartë të kompetencave të secilit prej inspektorateve dhe e ndarjes konkrete të tyre duke shmangur mundësitë e mbivendosjeve dhe konflikteve të mundshme mbi iniciativën për inspektim.** Sa i takon çështjes së ndarjes së kompetencave, është e nevojshme që ajo ta gjejë adresimin e saj në ligj, pasi dispozitat ligjore, në raport me akte të tjera që vendosin linja bashkëpunimi midis institucioneve, siç janë memorandumet e bashkëpunimit, në çdo rast, ofrojnë një nivel shumë më të lartë sigurie për zbatimin e tyre për shkak të: (i) tiparit të detyrueshmërisë përkundër tiparit të vullnetit të palëve; dhe (ii) vazhdimësisë në kohë, qëndrueshmërisë.

Në lidhje me ndarjen e kompetencave të inspektimit, do të ishte e përshtatshme që atribuimi i detyrës për kryerjen e inspektimeve të mbante në konsideratë llojet konkrete të inspektimeve që parashikohen nga kuadri ligjor në fuqi dhe konkretisht:

- a) Inspektime për efekt të procedimit disiplinor, i cili mund të jetë tematik apo i përgjithshëm;
- b) Inspektime për efekt të vlerësimit profesional, i cili mund të jetë tematik apo i përgjithshëm;
- c) Inspektime tematike ose të përgjithshme, që synojnë evidentimin e problemeve me karakter të përgjithshëm, siç mund të jetë mundësia e përmirësimit të legjislacionit apo ngarkesa në punë.

*A. Inspektimet për efekt të procedimit disiplinor, duhet të shihet i lidhur ngushtësisht me të drejtën e nisjes së procedimit disiplinor. Përsa kohë e drejta për të nisur procedim disiplinor sipas ligjit, i njihet Ministrin të Drejtësisë, është e përshtatshme që*

edhe kompetenca për inspektimin t'i lihet këtij institucioni. Kjo do të kërkonte që çdo ankesë e paraqitur gabimisht në KLD t'i përcillej menjëherë Ministrit të Drejtësisë, duke mos e lënë në çmuarjen e Këshillit . Gjithashtu, kur gjatë kryerjes së procedurës së vlerësimit profesional apo inspektimeve tematike apo të përgjithshme, që synojnë evidentimin e problemeve me karakter të përgjithshëm, KLD vëren shkaqe për procedim disiplinor të gjyqtarëve, duhet t'i kërkojë Ministrit të Drejtësisë fillimin e procesit të inspektimit, për të konkluduar ky i fundit nëse potencialisht mund të ketë vend për procedim disiplinor. Në këtë rast, KLD nuk duhet të dalë me konkluzione mbi mundësinë e procedimit disiplinor, por duhet të luajë një rol të ngjashëm me subjektet që paraqesin ankesë në Ministrinë e Drejtësisë. Për të shmangur pushtetin e panevojshëm diskrecional të Ministrit të Drejtësisë, të rrezikuar shpesh edhe nga konteksti politik, mund të vendoset edhe mekanizmi i vlerësimit, nga një komision i përhershëm i KLD-së, i mënyrës së përfundimit të procedimit disiplinor nga Ministri.

*B. Inspektimet për efekt të vlerësimit profesional*, duke qenë se në këtë pikë ligji nuk paraqet mangësi, është e përshtatshme që kompetenca për kryerjen e këtyre inspektimeve të vazhdojë t'i mbetet ekskluzivisht KLD-së. Ministri i Drejtësisë, të dhëna që merr nga inspektimi për efekt të procedimit disiplinor mund t'i verë në dispozicion të KLD-së, gjatë fazës së miratimit të raportit të Kryeinspektorit të KLD-së për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, por në asnjë rast nuk mund të kryejë inspektime për efekt të vlerësimit profesional të gjyqtarëve.

*C. Inspektimet tematike ose të përgjithshme*, që synojnë evidentimin e problemeve me karakter të përgjithshëm, kompetenca për të cilat aktualisht iu njihet të dy institucioneve, është e përshtatshme që të vazhdojë të realizohet nga të dy institucionet. Të dhënat e siguruar nga këto inspektime mund të shërbejnë për propozimin e politikave apo ndryshimeve ligjore, në rastet kur vërehet se problemi duhet adresuar përmes një reforme ligjore apo institucionale. Nga ana tjetër, ato mund të shërbejnë për të evidentuar një fenomen të caktuar në sistemin gjyqësor, apo për të orientuar KLD-në mbi nevojat që kanë gjyqtarët për trajnime. Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, mund të përdorë të dhënat e inspektimeve tematike apo të përgjithshme, edhe për të evidentuar raste të mundshme për procedim disiplinor, sikundër KLD për të përmbushur funksionin e vet për vlerësimin profesional të gjyqtarëve.

Në këtë kuadër, ligji duhet të parashikojë koordinimin e veprimtarisë së dy inspektorateve, duke vendosur rregulla për bashkëpunimin ndërinstitutional në përvijimin e një programi të qartë pune në fillim të çdo viti, të hartuar dhe të vënë në zbatim përmes një marrëveshjeje të përbashkët. Kjo marrëveshje duhet të shmangë në çdo mënyrë mbivendosjen e inspektimeve nga të dy institucionet, duke siguruar në këtë mënyrë përdorimin maksimal të burimeve njerëzore. E rëndësishme është që bashkëpunimi në këtë aspekt të mos lihet në vullnetin e palëve por të burojë drejtpërdrejtë si detyrim nga ligji.

Përveç sa më sipër, është e nevojshme që **ligji për Ministrinë e Drejtësisë të parashikojë në mënyrë të qartë detyrat dhe rregullat mbi ushtrimin e**

**veprimtarisë së inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë.** Gjithashtu, është e domosdoshme që të përcaktohen **kritere dhe procedura të qarta në lidhje me trajtimin e ankesave**, si dhe në funksion të transparencës, të përvijohen parashikime mbi mundësinë e qytetarëve për t'u vënë në dijeni në lidhje me ecurinë dhe rezultatin e inspektimeve në rastet kur këto inspektime janë iniciuar mbi bazën e një ankesë.

Nga ana tjetër, në funksion të efektivitetit dhe efijencës në ushtrimin e inspektimeve është i domosdoshëm **forcimi i kapaciteteve të inspektimit në aspektet sasiorë dhe cilësorë**, duke rritur numrin organik të inspektorateve, por edhe kërkesat që duhet të përmbushin inspektorët dhe elementët e statusit të tyre. Me qëllim maksimalizimit e rezultateve të profesionalizmit dhe efijencës, është e nevojshme që inspektoratet të përthithin një elitë gjyqtarësh për të cilët emërimi si inspektorë të konsiderohet si promovim. Në këtë kontekst, krahas kërkesave të larta në lidhje me përvojën profesionale të inspektorëve, atyre duhet t'u sigurohet një status i tillë që të sigurojë edhe përmbushjen e kërkesave të gjyqtarëve të aftë duke i tërhequr ata drejt këtij pozicioni.

Gjithashtu, **kërkesat për efektivitet në ushtrimin e funksioneve kërkojnë trajnimin e vazhdueshëm të inspektorëve.** Ligji nr. 9877/2008 parashikon detyrimin e gjyqtarëve për trajnime vazhduese me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të tyre profesionale dhe për të njohur më mirë tendencat më të fundit në legjislacion. Në këtë kuadër është e nevojshme që edhe inspektorët të ruajnë të njëjtin zhvillim profesional si gjyqtarët që inspektojnë. Kjo do të kërkonte një parashikim detyrues në ligj mbi trajnimin vazhdues të tyre.

Nga ana tjetër, në dritën e tendencave më të fundit të organizimit të gjyqësorit, ndërsa tentohet gjithmonë e më shumë drejt “profilizimit” të gjykatave, është e rekomandueshme që **një tendencë e tillë profilizimi të reflektohet në të ardhmen edhe në përbërjen e inspektorateve.** Konkretisht, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2007-2013, ka përcaktuar si përparësi për periudhën afatgjatë, ndër të tjera, krijimin e gjykatave të specializuara, administrative dhe tregtare. E ndërsa është projektligji mbi gjykatat administrative pritet të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, ndërkohë që ka kaluar fazën e shqyrtimit në komisionet e përhershme parlamentare dhe krijimi i gjykatave tregtare përbën përparësi për të ardhmen, rekomandohet që në perspektivën afatgjatë edhe inspektorët të profilizohen sipas profilizimit të gjykatave, në mënyrë që t'i përgjigjen me efektivitet dhe profesionalizëm kërkesave dhe zhvillimeve të sistemit gjyqësor.

Adresimi i të gjitha këtyre çështjeve do të kërkonte:

**A.** Ndryshimin e ligjit nr. 8811/17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i ndryshuar;

**B.** Ndryshimi i ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;

**C.** Forcimin e kapaciteteve përmes përmirësimit të procedurave të rekrutimit të inspektorëve në të dy inspektoratet;

**D.** Trajnimin e inspektorëve të të dy inspektorateve, në vijimësi;

**E.** Profilizimin e inspektorëve, në të ardhmen, si rrjedhojë e krijimit të gjykatave të specializuara.